



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA LIBRAZHD**

Data 16/04/2026

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE TE
VEÇANTA PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Sistemim asfaltim i rruges fshati Xhyre Njesia Administrative Hotolisht”.

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Asfalt cakell dhe rere bitumi

VLERA E FONDIT LIMIT: 24,999,308 (njetzet e kater milion e nenteqind e nentedhjete e nente mije e treqind e tete) leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TE KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet te paraqese:

- a. Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas shtojces 8,*
- b. Sigurimin e Ofertes, sipas Shtojces 3;*

Argumentimi: Kriteri (a) eshte vendosur ne baze te nenit 83 të LPP dhe nenit 30 pika 1 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Kriteri (b) bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

1.1 Pershtatshmeria per te kryer veprimtarine profesionale:

Sipas kriterëve te pergjithshme te perzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kesaj shtojce (Shtojca 7).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar si dhe në ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të biznesit”, të ndryshuar.

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatoret ekonomike duhet te paraqesin vertetim per xhiron vjetore per vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025**, ku vlera e xhiros per 3 (*tre*) vitet e fundit duhet te jetë jo më e vogël se **vlera e fondit limit qe prokurohet**.

2.1.1 Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 shkronja c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën

2.1.2 Operatoret ekonomike duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025**, të shoqeruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar nenin 43, pika 4 të VKM-së Nr.285 datë 05.03.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Ligjin nr.10091 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. i cili parashikon se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.1.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha **detyrimet e taksave dhe tarifave vendore**, lëshuar nga Pushteti Vendor, **për vitin 2025 në të gjitha vendet ku ka ushtruar aktivitetin** referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument në momentin e dorëzimit të dokumentave).

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i ka shlyer detyrimet e taksave dhe të tarifave vendore për vitin 2023, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar sipas të cilit operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrojnë aktivitetin, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore, në Ligjin Nr. 9 920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin Nr. 131/2015 “Për QKB” i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr. 9 723, datë 03.05.2007 “Për QKR”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti teknik:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme duhet të paraqiten:

- **Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore:**

a) Kontraten e Siper marrjes,

b) Situacionin përfundimtar të objektit

c) Fatura Tatimore

d) Aktin e Kolaudimit të objektit

e) Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

f) Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar të punimeve.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- **Nëse kontrata është realizuar me subjekte private:**

a) Kontraten e Siper marrjes,

b) Situacionin përfundimtar të objektit

c) Faturat Tatimore

d) Aktin e Kolaudimit të objektit

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojën e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Kontraten e bashkimit të operatoreve dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit;
- Per kontratat e realizuara si Nenkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:
Kontratë baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor.

Formular vlerësimi

Situacion Përfundimtar & Faturat Tatimore

Pika a) plotësohet nga anetari i cili ka përqindjen me të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anetaret e tjere të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse **pika b)** duhet të plotësohet nga të gjithë anetaret e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatoreve shoqeruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, mbështetur në parashikimet e nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni AK ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

2.2.2 Operatoret ekonomike duhet te deshmojne se disponojne license profesionale per zbatim punimesh ne ndertim si dhe ne license te disponojne kategorite e nevojshme per zbatimin e kontrates. Per kete duhet te paraqesin licensen perkatese te shoqerise, bazuar ne formatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr.42, date 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve huridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”, i ndryshuar.

Licensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates duhet te permbaje kategorite e meposhtme:

Per punimet e pergjithshme te ndertimit:

- **Kategoria NP-1** – Punime Germimi ne toke – **Klasifikimi B**
- **Kategoria NP-4** – Rruge autostrada – **Klasifikimi B**

Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme nëlicensë:

- **Kategoria NS-4** – Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese – **Klasifikimi B**
- **Kategoria NS-18** – Punime topogjeodezike – **Klasifikimi B**

** Per Operatoret e huaj te behet njehesimi i licenses profesionale qe disponojne nga vendi i origjines prane Ministrise se Puneve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit ne plotesimin e licensave profesionale te kerkuara per ekzekutimin e kontrates.*

** Ne rast te bashkimit te operatoreve ekonomike, Licensat profesionale duhet t’i paraqese operatori ekonomik qe ka marre persiper punimet per te cilat kerkohet Licensa Profesionale.*

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4).

** Per Operatoret e huaj te behet njehesimi i licenses profesionale qe disponojne nga vendi i origjines prane Ministrise se Puneve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit ne plotesimin e licensave profesionale te kerkuara per ekzekutimin e kontrates.*

** Ne rast te bashkimit te operatoreve ekonomike, Licensat profesionale duhet t’i paraqese operatori ekonomik qe ka marre persiper punimet per te cilat kerkohet Licensa Profesionale.*

<i>Kategoria e kërkuar</i>	<i>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</i>	<i>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në</i>	<i>Niveli i klasifikimit i kërkuar</i>	<i>Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në</i>
----------------------------	---	--	--	--

		<i>kategorinë përkatëse</i>	<i>për</i>	<i>preventiv,</i>
			<i>kategorinë që përfshihen në</i>	<i>respektive kategorinë</i>
			<i>përkatëse</i>	
<i>NP-1</i>	<i>Punime gjurmimi në tokë.</i>	<i>Punime gjurmim dheu</i>	<i>B</i>	<i>21-50 milion</i>
<i>NP-4</i>	<i>Rruge autostrada</i>	<i>Punime për shtresat asfaltike</i>	<i>B</i>	<i>21-50 milion</i>
<i>NS-4</i>	<i>Punime rifiniture të muratës dhe të lidhura me to</i>	<i>Ndërtim mure me blloqe betoni</i>	<i>B</i>	<i>21-50 milion</i>
<i>NS-18</i>	<i>Punime topogjeodezike</i>	<i>Piketimin e punimeve</i>	<i>B</i>	<i>21-50 milion</i>

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën ISO, si më poshtë:

ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë)

ISO 14001:2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor)

ISO 45001:2018 (Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë)

Çertifikata e mesiperme duhet të jetë e vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse çertifikata është në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar. Çertifikata e mesiperme duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Ne rast të bashkimit të operatoreve ekonomike ISO duhet plotësuar nga operatorët ekonomike, sipas natyrës së punëve që marrin përsipër.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, si dhe nenit nr. 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe bazuar në nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurimet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, të ndryshuar, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë çertifikatën, të lëshuar nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Duke qenë se përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi është Autoriteti Kontraktor, gëzon të drejtën për t'u garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për punët që do të

kryhen, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar”.

- Për ISO 9001 - 2015; Kjo certifikate specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një operator ekonomik duhet të tregojë aftësinë e tij që vazhdimisht të sigurojë punë/mallra ose shërbime që plotësojnë kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatore, si dhe synon të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit duke përfshirë edhe proceset për përmirësim të vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit të klientit dhe kushtet e aplikueshme ligjore dhe rregullatore si dhe meqënëse Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kërkon që punimet që do të kryhen të jenë në cilësinë më të lartë është përcaktuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me këtë standart cilësie.

- Per ISO 14001 – 2015: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 14001 – 2015, standart ky që vlerëson sipas përkufizimit të tij përgjegjshmërinë e kompanive ndaj mjedisit. Standardet e Sistemit të Menaxhimit - që vlerësojnë nivelin e sistemit të zhvillimit dhe integritit të përgjegjësive ndaj mjedisit në të gjithë kompaninë. Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kërkon një manaxhim të aktivitetit përkushtuar parandalimit të ndotjes dhe të përmirësimit të ndikimeve mjedisore.

- Per ISO 45001:2018: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 45001:2018, standart ky që përcakton kërkesat minimale të shëndetit në punë dhe praktikën më të mira të menaxhimit të sigurisë. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi shëndetësor optimal dhe menaxhimin e sigurisë në punë. Kjo mund të ndihmojë për të vënë në vend politikën, procedurat dhe kontrollet e nevojshme për çdo lloj biznesi për të arritur kushtet më të mira të mundshme të punës, një linjë me praktikën më të mirë të njohur ndërkombëtare

- ISO 3834-2:2021, standart ky që përcakton rëndësi dhe fushëveprim të produkteve kritike të sigurisë, kompleksiteti i prodhimit, koha e përdorimit të prodhimeve të prodhuara, sfera e problemeve metalurgjike që mund të ndodhin, defektet, deformimet ose defektet e saldimit që ndikojnë në performancën e produktit në kuptimin e fushës së kualitetit të detajuar, standart dhe themelor të cilësisë ISO 3834-2.

2.2.4 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **60 (gjashtedhjetë) punonjës** me kohe të plote pune për periudhën e *muajit të fundit* nga data e hapjes së ofertave, ku Stafit Teknik dhe punëtorët e kualifikuar të jenë me kohe të plote pune për periudhën e *muajit të fundit* nga data e hapjes së ofertave

Per vertetimin e këtij kushti të paraqiten:

1. Vertetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mesipërme.
2. Listepagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mesipërme.

Argumentim: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, nenit 77, të ligjit nr 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik “ dhe nenit 39, Pika 6/ç, të VKM nr 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të deshmojnë që kanë fuqi minimale puntore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Autoriteti kontraktor në përcaktimin e fuqisë puntore të nevojshme për realizimin e kontratës ka bërë një përllogaritje të numrit të punonjësve duke përcaktuar fillimisht orët e punës në bazë të analizës sipas manualit teknik të çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr 216 Datë: 13.04.2023” Për Krijimin dhe Funkcionimin e Sistemit të Integruar për Informatizimin e Manualit të Çmimeve për Zërat e Punimeve në Ndërtim në këtë kontekst autoriteti kontraktor ka përcaktuar numrin e punonjësve referuar një përllogaritje të saktë të bërë referuar zërave të punimeve për objektin e prokurimit orëve të punës (8 orë në ditë për çdo punonjës) afatit kohor të realizimit të kontratës si dhe shpërndarjes së

punës. Në numrin e përcaktuar për fuqine puntore janë përlllogaritur punetoret e kualifikua . Nga përlllogaritja e orëve të punës për çdo zë pune rezulton se për kryerjen e punimeve sipas grafikut të punimeve duhen **60 (tridhjetë e gjashtë)** punonjës me kohe te plote.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje 3 (tre) muajt e fundit tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë puntore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit i parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruar me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

2.2.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjës të specialiste dhe çertifikimet përkatëse, si me poshte:

- a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçence të shoqërisë e të punësuar si drejtues Teknik në stafin e tij për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontrate pune të vlefshme, diplome, CV, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.4, stafin inxhinierik si me poshte:

Minimuni 1 (një) **Inxhinier Ndertimi**

Minimuni 1 (një) **Inxhinier Mjedis**

Minimuni 1 (një) **Inxhinier Mekanik**

Minimuni 1 (një) **Inxhinier Hidroteknik**

Minimuni 1 (një) **Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshejder**

Minimuni 1 (një) **Inxhinier Gjeolog**

Minimuni 1 (një) **Inxhinier Gjeoteknik**

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri Mekanik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve të cilat kanë të bëjnë , referuar punimeve të parashikuara në preventiv.
- **Inxhinieri Gjeodet/Topograf** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv., me qëllimin për realizimin me cilësi dhe kushte sipas standarteve.
- **Inxhinier Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve të cilat kanë të bëjnë me tombinot dhe levizjen e ujit për shmangien e tij nga asfalti, referuar punimeve të parashikuara në preventiv.
- **Inxhinier Gjeoteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore për shtratat e mbushjeve dhe të dherave, referuar punimeve të parashikuara në preventiv.

b) Staf i mbështetës Operatori ekonomik duhet të ketë të disponojë dokumentacionin që verteton profesionin si: Dëshmi profesionale të punonjesve ose ekuivalent të tij/saj , punonjesit e mëposhtëm me specialitetin si dhe të figurojnë në listat e shoqërisë sipas pikës mëposhtme (2.3.4) :

- 1 (një) Teknik i mesëm Ndërtimi (Diplome e shkolles mesme)
- 1 (një) Teknik i mesëm Topograf (Diplome e shkolles mesme)
- 1 (një) Teknik i mesëm Gjeometër (Diplome e shkolles mesme)
- 1 (një) Teknik i mesëm Mekanik (Diplome e shkolles mesme)
- 5 (pese) Punëtor Asfalti (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 5 (Pese) Betonues (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 2 (dy) Karpentier (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 2 (dy) Hekurkthyes (Me Certificate Trajnimi / Diplome)

* Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë dokumentacionin që verteton profesionin si :

- Kontratat e punës individuale të vlefshme
- Për stafin e mesiperm, Dëshmia e kualifikimit/ certificate dhe/ose diploma e cila të jetë e leshuar nga Ministria e Financave ose të njihet nga Ministria e Punës Ceshtjeve Sociale të paraqitet certificate/diploma profesionale për secilin. Certificate / diplomat duhet të jenë të leshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit nr. 15/2017 “*Per arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh.*”, i ndryshuar. Kjo kërkesë po ashtu është në përputhje me vendimin nr. 441/2020, datë 09.10.2020 të Komisionit të Prokurimit Publik. Diplomat/certificate të paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licensuara sipas legjisllacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbejnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike.
- **Diplome** nga institucionet e arsimit të mesëm profesional (publik/privat) të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “*Per arsimin dhe formimin profesional ne RSH*”, kontrate pune të vlefshme dhe të figurojë në listat e shoqërisë.
- Operatori ekonomik të paraqes deklaratë në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtëm:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit të marrëdhënieve të punës	Nr. Amzës/ekuivalent diplomes/certificate profesionale	Institucioni/ Subjekti certificate	Data e vlefshmerisë së certificate profesionale

Kriteri konsiderohet i permbushur me paraqitjen e formularit te vetedeklarimit sipas shtojces 8 te DST.

Shenim: Referuar pikes 1, te nenit 26, te VKM nr.285, date 19.05.2021, i **ndryshuar**, ku parashikohet : *“Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetedeklarimit, sipas percaktimit në nenin 82, të LPP-se, dhe në këto rregulla”,* si dhe percaktimet e pikes 6, te ketij neni, ku parashikohet: **“Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar, i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” te pikes 2 te ketij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne origjinal ose ne kopje te njesuara me origjinalin”.**

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Numri është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

c) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vertetuar me kontratë pune të vlefshme, të pajisur me çertifikate/dëshmi trajnimi të leshuar nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.4, punonjës me specialitetin si më poshtë:

d) **(nje)** person, pjesë e stafit të shoqërisë, duhet të jetë i certifikuar si **Ekspert Zjarrfikës** në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin,

(Për ekspertin zjarrfikës çertifikata e ekspertit zjarrfikës si dhe Kontrata e punës (e vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar të ndertimit si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit).

e) **1(nje)** person, pjesë e stafit të shoqërisë, duhet të jetë i certifikuar si **Ekspert për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis**,

(Për ekspertin e Mjedisit çertifikata e ekspertit Mjedisor si dhe Kontrata e punës e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit).

- f) **1(nje)** person, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jene te pajisur me certifikaten te Trajnimit per *"Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune"*, *"Pergjegjes per sigurine"*, e dhene nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj,
- g) Operatori ekonomik duhet te ketë në stafin e tij, **1(nje)** persona te certifikuar per *"Ndihmen e pare dhe ndërhyrje ndaj emergjencave"*, te cilet duhet te figurojne ne listepagese minimalisht per 3 (tre) muajt e fundit).
- h) Operatori ekonomik duhet te kete ne stafin e tij **4 (kater)** persona specialist te certifikuar per *"Punime ne lartesi"*, te cilet duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise. Detyrimisht te paraqitet kontrate pune dhe certifikata perkatese te tyre.
- i) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë **1(nje)** mjek ndërmarrjeje, kjo të vërtetohet me paraqitjen Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe Kontratës së Punës së mjekut me operatorin ekonomik e cila duhet te jete detyrimisht noteriale dhe e vlefshme për periudhën e ndërtimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" I ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Në mbështetje të nenit 7 të Ligjit Nr:10 237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" ku citohet. "Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale nëndërmarrje/institucion.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si dhe të përfshirë në listepagesa për periudhën 3 muajt e fundit, me profesionet si mëposhtë:

Lloji i Specialistit	Numri i kerkuar
• Teknik Ndertimi	2
• Teknik Topograf/Gjeodet	1
• Murator	3
• Karpentier	1
• Hekurkthyes	1
• Betonues	1
• Saldator	1
• Specialist ndertimi	1
• Hidraulik	2
• Bojaxhi	2

Per kete operatoret ekonomike duhet te paraqesin :

- Kontratat e punes te vlefshme;
- Dokument (deshmi kualifikimi profesional), qe te vertetoje kualifikimin profesional te kerkuar, referuar rregullores *“Per kushtet, kriteret dhe programet per pergatitjen teoriko-praktike te kandidateve, si dhe dhenien e Deshmise se Aftesise Profesionale per perdoruesit e makinerive te renda per punime ndertime dhe toke, si dhe disiplinimi i perdorimit te tyre”*, miratuar me urdherin nr. 200, date 16.5.2019, te Ministrit te Infrastruktures dhe Energjitikes.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet plotesimit dhe paraqitjes nga operatoret ekonomike te formularit permbledhes te vetedeklarimit, sipas shtojces 8 te DST.

Dokumentacioni provues do te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar ne vend te pare, prane autoritetit kontraktor, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, ose nese do te jete nevoja per tu kerkuar sqarime nga AK.

2.2.6 Operatori ekonomik duhet te paraqese Kontate Furnizimi Per Materialet si me poshte:

3 Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion (kapaciteti mbajtës minimum 11(njëmbëdhjetë) ton dhe maksimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pesë) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pike pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion (kapaciteti mbajtës mbi 20 (njetete) ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Dumper kantieri	2 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma (mjet teknologjik me goma)	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	2 copë	Pronësi ose me qera
Autopompe Betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri teknologjike (trancher) per frezim dhe hapje kanali me thellesi mbi 50 cm ne rruge te asfaltuara / Bobcat	1 copë	Pronësi ose me qera
Telehender/Pirun	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me vinc	1 copë	Pronësi ose me qera
RTV Rimorkiator ose Karrotrec	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhire	2 copë	Pronësi ose me qera
Rrul vibrues (ngjeshes)	2 copë	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera
Grejder	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobitumatrice me goma (ose mobile)	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri/Pajisje vijezi	1 copë	Pronësi ose me qera
Prerese sharre Asfalti/Betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik Hidraulik/Pneumatik	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni (te brendshem)	4 copë	Pronësi ose me qera
Tokmak me karb. ose elekt., per ngjeshje	2 copë	Pronësi ose me qera
Kontenier Stacioner (zyre ne objekt)	1 copë	Pronësi ose me qera
Prozhektore kantieri	2 copë	Pronësi ose me qera
Gjeneratore	2 copë	Pronësi ose me qera
GPS per rilevime matje/azhornime topografike	1 copë	Pronësi ose me qera
Fabrike Betoni, pajisur me leje mjedisore nga QKL / ose mobile e levizeshme	1 copë	Pronësi ose me qera ose me kontrate/marreveshje furnizimi/bashkepunimi
Nyje Inertesh, pajisur me leje mjedisore nga QKL / ose mobile e levizeshme	1 copë	Pronësi ose me qera ose me kontrate/marreveshje furnizimi/bashkepunimi
Fabrike Asfalti pajisur me leje mjedisore nga QKL / ose mobile e levizeshme	1 copë	Pronësi ose me qera ose me kontrate/marreveshje

		furnizimi/bashkepunimi
--	--	------------------------

Operatori ekonomik pjesemarres, per realizimin e kontrates, duhet te disponoje, automjetet dhe pajisjet (sipas tabelës) te cilat duhet te jene ne pronesi te tij ose me qira te vertetuara keto me dokumentacionin perkates;

- a) Gjithashtu ne zbatim te VKM-se Nr.312, date 05.05.2010, operatori ekonomik pjesemarres duhet te disponoje mjete dhe pajisje mbrojtjes ne pune te punetoreve, personelit, si me poshte:
- b) Kokore minimumi 60copë
 - c) Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 10copë
 - d) Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5copë
 - e) Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5copë
 - f) Uniforma/Jelek pune 60cope
 - g) Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15copë

Argumentimi:

Ligjor: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Gjithashtu kriteri është vendosur referuar zerave te punimeve.

Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomik mjetet dhe pajisjet teknike Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatëse ne lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi.

Mjetet e mësipërme kërkohen duke u bazuar në proceset e punës, volumet e punimeve të preventivit dhe grafikut të punimeve të kryera gjatë javës ku shënohet dhe piku i punimeve dhe dukeu bazuar në shpërndarjen e punimeve në objekt dhe certifikatën e kontrollit teknik të mjeteve rrugore.

□ Per vertetimin e disponimit te makinerive dhe pajisjeve te kerkuara me lart, te paraqiten:

- 1- Per mjetet qe shenohen ne rregjistra publike duhet te paraqitet dokument qe verteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikaten e Kontrollit Teknik (*te vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*te vlefshme*).Certifikate per transportin e mallrave
- 2- Per mjetet e siguruar me qira, te paraqitet kontrata e lidhur para noterit per kete objekt, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt e ketij prokurimi, shoqeruar me Akt - Pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar plus dokumentat qe verteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikaten e Kontrollit Teknik (*te*

vlefshme), Siguracionin e mjetit (te vlefshme). *Certifikate per transportin e mallrave per te trete*

- 3- Per paisjet ne pronesi te shoqerohen me Akt - Pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi*).
- 4- Per paisjet me qera te paraqitet kontrata e lidhur para noterit per kete objekt, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt e ketij prokurimi, shoqeruar me Akt - Pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi*).
- 5- Operatori ekonomik nuk duhet t'i kete kapacitetet teknike te angazhuara ne kontratat te tjera dhe nuk duhet te jene te deklarurara ne proçedura te shpallura fituese **(deklarate me shkrim nga Administratori i Shoqerise)**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", te ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

NJESIA E PROKURIMIT